



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:074945

Datë: 09.10.2024

Numri i dokumentit: 06271846

CA.nr.10373/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Lumni Sallauka - kryetar i kolegjit, Hunaida Pasuli dhe Frosina Sylejmani - anëtare të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësve-propozuesve F.M, E.A, B.A dhe K.B që të gjithë nga F..., rr. “W. C”, banesa nr...., hyrja numër ..., të cilët me autorizim i përfaqëson av. E.Z, kundër të paditurit-kundërpropozuesit A.(Sh) E nga F..., rr. “D.e K”, të cilin me autorizim e përfaqëson A.E, lidhur me propozimin për caktimin e masës së sigurisë, duke vendosur sipas ankesës së propozuesve, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.2023:074946, të datës 29.03.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë **07.10.2024**, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa propozuesve të masës së sigurimit F.M , E.A, B.A dhe K.B që të gjithë nga F..., ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.2023:074946, i datës 29.03.2024, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e ankimuar, C.nr.2023:074946, të datës 29.03.2024, ka vendosur si në vijim: *“I.REFUZOHET - propozimi i paditësve-propozuesve F.M, E.A, V.A dhe K.B, me të cilën kanë kërkuar që të CAKTOHET MASA E SIGURISË dhe t’i NDALOHET kundërpropozuesit çdo veprim në drejtim të riparimit, tjetërsimit, rrënimit të bodrumeve dhe ndryshimit të gjendjes së tyre në paluajtshmëritë e cekura në kërkesëpadi të paditësit dhe atë tërësisht madje duke ia ndryshuar edhe destinimin, me çka dëmtohet pjesa e pasurisë së paluajtshme të evidentuara në certifikatën e pronës së patundshme njësia O-72217092-0229-0-12-1-4-0, deri sa të përfundoj për rastin konkret çështja kontestimore, SI E PA BAZUAR. II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.”*

Kundër këtij aktvendimi, brenda afatit ligjor, propozuesit e masës së sigurimit, përmes të autorizuarit të tyre, kanë paraqitur ankesë për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore dhe për shkak të konstatimi të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, me propozimin që Gjykata e Apelit ta aprovoj ankesën e propozuesve të sigurisë, aktvendimin e goditur ta anuloj dhe çështjen ta kthej në rivendosje ose të vendos në mënyrë meritore

Kundërshtari i masës së sigurimit nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar dhe komplet shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

- Ankesa e propozuesve të masës së sigurimit, është e **pathemeltë**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se propozuesit e masës së sigurimit, përmes të autorizuarit të tyre, me datën 24.03.2024, në gjykatën e shkallës së parë kanë paraqitur padi për vërtetim pronësie, me propozim për caktimin e masës së sigurimit, ndaj kundërshtarit të masës së sigurisë, me kërkesë që kundërshtarit të masës t'i ndalohet çdo veprim në drejtim të riparimit, tjetërsimit, rrënimit të bodrumeve dhe ndryshimit të gjendjes së tyre në paluajtshmëritë e cekura në kërkesëpadi të paditësit dhe atë tërësisht madje duke ia ndryshuar edhe destinimin, me çka dëmtohet pjesa e pasurisë së paluajtshme të evidentuara në certifikatën e pronës së patundshme njësia O-72217092-0229-0-12-1-4-0, deri sa të përfundoj për rastin konkret çështja kontestimore *(me gjerësisht sikurse në propozimin për caktimin e masë së sigurimit)*.

Duke vepruar sipas propozimit të propozuesve, gjykata e shkallës së parë ka mbajtur seancën dëgjimore dhe pas administrimit të provave, ka ardhur në përfundim se propozimi i propozuesve për caktimin e masës së sigurisë, është i pa bazuar, për çka edhe ka vendosur që ta refuzon, duke vendosur decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar C.nr.2023:074946, të datës 29.03.2024.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ndër të tjera ka arsyetuar se pas administrimit të provave në këtë çështje, analizimit dhe vlerësimit të tyre ka çmuar se kërkesa e paditësve-propozuesve për caktimin e masës së sigurisë nuk është e besueshme, ashtu siç është e paraparë në nenin 297 të LPK-së. Ka shtuar se Gjykata vlerëson se paditësi me asnjë provë nuk e ka bërë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të drejtës subjektive për bodrumin objekt i këtij kontesti, i njëjti këtë e kërkon mbi bazën e kontratës së shitblerjes të datës 08.09.2006 të vërtetuar në Gjykatë me nr. .../06 të datës 11.09.2006, të lidhur në mes tij si blerës dhe në mes shitësit Sh. L. B. Në këtë kontratë theksohet se së bashku me banesën e blerë përfshihet edhe 1 (një) bodrum, mirëpo nuk specifikohet se ky bodrum në cilin vend ndodhet, nuk është cekur numri i tij kadastral dhe as sipërfaqja e tij, nuk i është bashkangjitur skica përkatëse gjeodezike e definimit të saktë të bodrumit dhe nuk janë bashkangjitur dëshmitë e nevojshme të cilat vërtetojnë se bodrumi ka qenë në pronësi të shitësit sipas kësaj kontrate, respektivisht pretendimi i paditësit se bodrumi ka qenë pjesë e banesës së blerë është jo besueshëm pasi ky pretendim nuk është vërtetuar me ndonjë provë tjetër të vlefshme të

administruar deri më tani në shqyrtim kryesor. Për më tepër, provat tjera të administruara si Marrëveshja e paditësit me AKM-në, dëshmon të kundërtën e pretendimit të propozuesit, pasi nga kjo provë del se bodrumi ka qenë pjesë përbërëse e lokalit, ku në procesin e privatizimit i është shitur këtu të paditurit dhe më pas regjistruar në procedurë të rregullt në Zyrën Kadastrale në Ferizaj. Çka do të thotë se, gjykata nuk mund të caktoj masë siguroese, nëse propozuesi nuk e bën të besueshme me prova bindëse se kërkesa e tij ndaj kundërpropozuesit është e bazuar, e të cilën deri në këtë fazë të procedurës nuk e ka bërë (*më gjerësisht sikurse në arsyetim të aktvendimit të atakuar*).

Gjykata e Apelit e pranon vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar me ankesë nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) të LPK, për të cilat Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkeljet e tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Gjykata e Apelit vlerëson se në këtë çështje kontestimore, gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejtë kur ka refuzuar si të pabazuar propozimin e propozuesve për caktimin e masës së sigurisë, duke konstatuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, pasi që nga shkresat e lëndës rezultojnë se propozuesit nuk kanë ofruar prova relevante dhe bindëse të cilat do të bënin që gjykata në bazë të tyre edhe të vendos që ta aprovoj propozimin e saj për caktimin e masës së sigurimit, por edhe nga ato prova që i ka bashkangjitur në shkresat e lëndës ka rezultuar se propozuesit nuk e kanë bërë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të drejtën e tyre subjektive dhe se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së sigurisë, pala kundërshtarë do të pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës, ashtu siç kërkohet me nenin 297 par.1 të LPK-së.

Në këtë drejtim, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, sipas dispozitës së nenit 297, paragrafi 1 pika a) dhe b) dhe 297 paragrafi 2 të LPK, përcaktohet në mënyrë të qartë se *“masa e sigurimit mund të caktohet në qoftë se plotësohen në mënyrë kumulative tri kushte dhe atë: besueshmëria ekzistimit të kërkesës apo të së drejtës subjektive, ekzistimi i rrezikut se pa caktimin e masës së sigurimit do të pamundësohet apo vështirësohet dukshëm realizimi i kërkesës dhe deponimi i garancionit”*. Në çdo rast kur nuk plotësohet ndonjëri nga kushtet e sipër theksuara atëherë gjykata nuk mund të vendosë për aprovimin e kërkesës për sigurimin e kërkesëpadisë. Në këtë rast Gjykata e Apelit e pranon në tërësi përfundimin e gjykatës së shkallës së parë se në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet për caktimin e masës së sigurimit, për shkak se propozuesit e masës së sigurimit nuk kanë ofruar prova me të cilat do ta bënin të besueshme në masë të mjaftueshme të drejtën e tyre subjektive në raport me rastin në fjalë dhe nuk e kanë provuar me prova konkrete materiale ekzistimin e rrezikut se pa caktimin e një mase të tillë propozuesve do t’iu pamundësohet apo vështirësohet dukshëm realizimi i kërkesës së tyre. Rrjedhimisht, Gjykata e Apelit vlerëson se qëndron arsyetimi i gjykatës së shkallës së parë se në rastin konkret bodrumet që janë objekt kontesti në këtë çështje, e përshkruara detajisht si në propozim, e për të cilët propozuesit kanë kërkuar që të caktohet masa e sigurisë, që t’i ndalohej kundërshtarit të propozimit, çdo veprim në drejtim të riparimit, tjetërsimit, rrënimit të bodrumeve

dhe ndryshimit të gjendjes së tyre të cekura si në propozim, në këtë fazë të procedurës nuk ndikon që të caktohet masa e sigurisë e kërkuar nga propozuesit, meqenëse ka rezultuar se të njëjtit nuk e kanë bërë të besueshme të drejtën e tyre subjektive pasi që nga ato prova që propozuesit kanë ofruar, përkatësisht nga kontrata e shitblerjes e datës 08.09.2006 të vërtetuar në gjykatë me nr. 3998/06, të datës 11.09.2006, të lidhur në propozuesit F.M si blerës dhe në mes shitësit SH.L.B nuk specifikohet se ky bodrum në cilin vend ndodhet, nuk është cekur numri i tij kadastral dhe as sipërfaqja e tij, nuk i është bashkangjitur skica përkatëse gjeodezike e definimit të saktë të bodrumit dhe nuk janë bashkangjitur dëshmitë e nevojshme të cilat vërtetojnë se bodrumi ka qenë në pronësi të shitësit sipas kësaj kontrate. Më tutje edhe në bazë të Marrëveshjes së paditësit-propozuesit me AKM-në, dëshmon të kundërtën e pretendimit të propozuesit, pasi nga kjo provë del se bodrumi ka qenë pjesë përbërëse e lokalit, ku në procesin e privatizimit i është shitur këtu të paditurit-kundërpropozuesit dhe më pas regjistruar në procedurë të rregullt në Zyrën Kadastrale në Ferizaj.

Andaj, në rastin konkret Gjykata e Apelit e pranon përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë për mos caktimin e masës së sigurimit, për shkak se kjo e fundit e ka arsyetuar në masë të mjaftueshme përfundimin e saj për refuzimin e caktimit të masës së sigurimit. Kjo për faktin se ka rezultuar se propozuesit e sigurimit nuk e kanë argumentuar faktin me prova konkrete të drejtën e saj subjektive, por as se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së tillë do të pamundësohet apo dukshëm do të vështirësohet realizimi i kërkesës siç ka kërkuar, ngase caktimi dhe qëllimi i masës së sigurimit është i ndryshëm nga epilogu përfundimtar i zgjidhjes së çështjes kryesore, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesve të sigurimit, gjegjësisht kundërshtari i sigurimit do të mund të ndërmerr çdo veprim në drejtim të riparimit, tjetërsimit, rrënimit të bodrumeve dhe ndryshimit të gjendjes së tyre, pasi që nuk ka prova që do të ndikojnë për vendosjen e masës së sigurisë, Gjykata e Apelit vlerëson se në kontekstin e rrethanave të paraqitura në këtë çështje juridike kontestuese e që i referohen pretendimeve të propozuesve të sigurimit lidhur me pretendimin e tyre për riparimin, tjetërsimin, rrënimin e bodrumeve dhe ndryshimit të gjendjes së tyre nga ana e kundërpropozuesit dhe në këtë fazë të procedurës konsiderohet i drejtë qëndrimi juridik e gjykatës së shkallës së parë se caktimi i masës së sigurisë në këtë fazë të procedurës nuk është i arsyeshëm dhe i bazuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejtë kur ka zbatuar dispozita e nenit 304.3 të LPK-së, ku është përcaktuar se *“propozuesi në propozimin e tij duhet t’i tregojë edhe faktet mbi të cilat mbështetet kërkesa e tij, si dhe të propozohen mjetet provuese me të cilat mund të provohen pretendimet e parashtruara në propozim”*, si dhe që këto *“mjete provuese t’ia bashkëngjisë propozimit”*.

Rrjedhimisht, Gjykata e Apelit vlerëson se me ndryshimin e rrethanave dhe me bazë të arsyeshme dhe të provuar në secilën fazë të procedurës, nuk do të thotë që propozuesi të mos ketë të drejtë të bëjë sërish propozim për caktimin e masës së sigurisë, me qëllim të mbrojtjes së të drejtave të saj subjektive, pasi që një mundësi të tillë e lejojnë dispozitat ligjore të LPK-së.

Gjykata e Apelit i ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera ankimore të paraqitura në ankesë, por ka gjetur se janë të pathemelta dhe se nuk ndikojnë që gjykata të merr një vendim ndryshe.

Në rastin konkret gjykata ankimore ka vlerësuar se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paraqitura me ankesë për shkak se gjykata e shkallë së parë përfundimin e saj e ka arsyetuar në masë të mjaftueshme sa i përket rrethanave që kanë ndikuar për refuzimin e kërkesës për caktimin e masës së sigurisë.

Përfundimisht, Gjykata e Apelit i ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore të parashtruara në ankesë, por nuk ka gjetur se ekziston ndonjë shkelje e cila do të ndikonte që vendimi të kualifikohet si i tillë për çka çështja pastaj do të duhej të kthehej në rishqyrtim.

Nga të cekurat më lartë, e në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 208 dhe 209 pika (b) e LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
CA.nr.10373/24, datë 07.10.2024

Kryetari kolegjit,
Lumni Sallauka